

Përfundon Faza e II e aplikimeve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme (PP): 27 kandidatë konkurrojnë për 15 pozicionet e shpallura në PP

- *27 kandidatë është numri total i prokurorëve, të cilët shprehën interes për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme: Pjesa më e madhe e kandidatëve janë pjesë e Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe Prokurorisë së Rretheve Gjyqësore*

Faza e parë e aplikimeve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, e cila u mbyll në 6 Shkurt 2019, solli aplikimin e 15 prokurorëve, të cilën shprehin interesin e tyre për të qenë pjesë e kësaj strukture. Megjithatë, me qëllim nxitjen e aplikimeve edhe të prokurorëve të tjerë me përvojë, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) ranë dakord për një zgjatje të afatit të aplikimeve deri në datën [21 Shkurt 2019](#). Aktualisht me përfundimin e afatit të dytë të vendosur nga KLP në [seancën plenare nr. 5](#), numri total i aplikimeve të prokurorëve kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme është [27](#).

Rreth gjysma e prokurorëve, të cilët kandidojnë për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme janë prokurorë aktualë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Për shkak të [përvojës profesionale hetimore dhe kritereve apo specifikave të tjera të kërkuara](#), këto prokurorë janë konsideruar ndër kandidatët më potencialë për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme. Ndërkohë gjatë fazës së dytë të aplikimeve, kanë shprehur interes për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme edhe ish-prokurorë, të cilët ushtrojnë aktualisht detyra të tjera jashtë sistemit të prokurorisë.

- *Emërimi i prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme: Përzgjedhja e prokurorëve nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) dhe konfirmimi në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK)*

Deri tani Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) ka konfirmuar në detyrë vetëm 5 nga 27 prokurorë, të cilët kanë aplikuar për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme. Duke qenë se procedurat e rivlerësimit kanë filluar për pjesën tjetër të prokurorëve, do të duhet që KPK të prioritarizojë vetting-un për këta kandidatë duke i përfshirë në kalendarin e seancave dëgjimore. Si rezultat i aplikimeve të reja edhe nga jashtë sistemit të prokurorisë, për një pjesë të kandidatëve procedurat e rivlerësimit nuk kanë filluar ende.

Përveç vetting-ut, dhe detyrimit ligjor për konfirmimin në detyrë të prokurorëve kandidatë në Prokurorinë e Posaçme, fillimisht Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të kryejë shqyrtimin dhe përzgjedhjen e prokurorëve kandidatë. Aktualisht KLP është duke përfunduar hartimin e [rregullores](#), e cila do të shërbejë për të përcaktuar metodologjinë e vlerësimit të prokurorëve, të cilët kandiduan për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme. Kjo rregullore do të përcaktojë

në mënyrë të detajuar kriteret për vlerësimin e këtyre prokurorëve dhe pritet të miratohet së shpejti me anë të një vendimi të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ky proces i shqyrtimit të dokumentacionit dhe dosjeve të prokurorëve kandidatë në PP do të realizohet nga vetë anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për shkak se ky organ vazhdon të ketë [mungesë të kapaciteteve administrative dhe burimeve financiare të mjaftueshme](#). Pas miratimit të rregullores, KLP ka parashikuar shqyrtimin e rreth 270 dosjeve të 27 prokurorëve kandidatë, duke llogaritur minimalisht rreth 10 dosje për kandidat. Për këtë arsye ky proces do të marrë një kohën e cila mund të [zgjaset në disa muaj](#).

- *10 prokurorë të posaçëm, numri minimal për fillimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme*

Si rezultat i numrit të ulët të aplikimeve dhe mos konfirmimeve në detyrë, pragu i numrit të prokurorëve për fillimin e ngrijtes së Prokurorisë së Posaçme ka hasur në diskutime edhe brenda vetë anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

[Edhe më parë](#) është sjellë në vëmendje përcaktimi kushtetues lidhur me numrin minimal të prokurorëve, i nevojshëm për të zgjedhur Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme dhe për të filluar ushtrimin e kompetencave të saj. Kushtetuta/Ligji parashikon që Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të duhet të emërojë në Prokurorinë e Posaçme jo më pak se 10 prokurorë, por diskutimet kanë konsistuar në faktin nëse kjo dispozitë është urdhëruese apo PP mund të fillojë të funksionojë edhe me më pak se 10 prokurorë duke e plotësuar strukturën në vijim.

Vetëm së fundmi [kryetari i KLP-së](#) ka pohuar që Prokuroria e Posaçme do të duhet të fillojë ushtrimin e kompetencave me minimalisht 10 prokurorë. Emërimi i prokurorëve në PP përbën një fazë mjaft të rëndësishme jo vetëm për fillimin e ngrijtes hap-pas-hapi të këtij institucioni të hetimit, por në të njëjtën kohë edhe të fillimit të krijimit të organit tjetër pjesë e SPAK, siç është Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH).

- *Nevoja e harmonizimit të fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (KKKO) dhe SPAK*

Megjithëse muaji shkurt parashikohej si afati përfundimtar për emërimin e përkohshëm të gjyqtarëve në Gjykatat KKKO dhe emërimin e prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme, duket se procesi do të kërkojë ende kohë. Në rastin e emërimit të prokurorëve tashmë KLP është shprehur zyrtarisht që ky proces do të kërkojë [disa muaj kohë](#) për shkak të kohës që do të duhet për të shqyrtuar një volum të konsiderueshëm dosjesh si edhe dhe vetting-ut të prokurorëve.

Ndërkohë në rastin e emërimit të gjyqtarëve, edhe pse procedurat janë disi më të thjeshtuara, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk është shprehur ende zyrtarisht mbi emërimin e përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda. Këto të fundit mund të kalojnë automatikisht në Gjykatat e Posaçme nëse ata dhe familjarët e afërt të tyre pranojnë të japin pëlqimin paraprak për kontrollin e vazhdueshëm periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake apo nëse ndaj tyre ka filluar procesi i rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK).

Funksionimi i Gjykatave KKKO dhe Strukturës së Posaçme SPAK është ndërtuar dhe duhet të funksionojë në mënyrë të harmonizuar. Fillimi i ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve të hetimit do të kërkojë bashkëpunimin dhe koordinimin me Gjykatat KKKO dhe anasjelltas. Vonesat e tejkaluara të ngritjes dhe funksionimit të njërit prej këtyre organeve do të krijojnë vakuum edhe në ushtrimin e kompetencave të strukturave të tjera kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

	Prokurorët kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme (PP)		Vendimi i KPK
1.	Klodian Braho	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
2.	Besnik Muçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Konfirmuar
3.	Anton Martini	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
4.	Edvin Kondili	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
5.	Ened Nakuçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
6.	Eugen Beci	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
7.	Doloreza Musabelliu	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
8.	Arben Kraja	Prokuror/Prokuroria e Përgjithshme	Konfirmuar
9.	Vladimir Mara	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
10.	Dritan Prençi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Konfirmuar
11.	Shkelzen Cena	Prokuror/Prokuroria Dibrës	Në proces
12.	Behar Dibra	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
13.	Besim Hajdarmataj	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
14.	Dorina Bejko	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec	Nuk ka filluar rivlerësimi
15.	Vatë Staka	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër	Konfirmuar
16.	Fatmir Hoxhaj	Drejtor-Drejtorja e Administrimit të Pronës Shtetërore, Ministria e Financave (ish-prokuror)	Nuk ka filluar rivlerësimi
17.	Altin Dumani	Prokuror/Prokuroria e Apelit Tiranë	Në proces
18.	Enkeleda Osmani (Xhengo)	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	Nuk ka filluar rivlerësimi
19.	Elida Kaçkini (Celami)	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Nuk ka filluar rivlerësimi
20.	Enkeleda Millonai	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan	Në proces
21.	Maksim Sota	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë	Nuk ka filluar rivlerësimi
22.	Donika Prela	Drejtuese/Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	Konfirmuar
23.	Elizabeta Imeraj	Drejtuese/ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Në proces
24.	Irena Nino (Vujoshi)	Anëtare e perkohshme pranë Komisionit të Monitorimit të Reformës në Drejtësi	Nuk ka filluar rivlerësimi
25.	Manjola Kajana	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
26.	Ndini Tavani	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Nuk ka filluar rivlerësimi
27.	Anita Jella	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	Nuk ka filluar rivlerësimi

* Lista e plotë e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme (PP). Burimi: Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), <http://klp.all/wp-content/uploads/2019/02/lista-e-aplikimeve-per-SPAK.pdf>

Miratohet struktura organike e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) për vitin 2019: Ende pa zgjidhje përfundimtare përcaktimi i godinës së KLP-së

- *Këshilli i Lartë Gjyqësor strukturë organike me 125 punonjës ndërsa Këshilli i Lartë i Prokurorisë me 65 punonjës*

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë përfunduan miratimin e strukturave respektive organizative, të cilat ju paraqitën gjatë muajit Janar Kuvendit të Shqipërisë. Për vitin 2019 [KLGJ parashikoi](#) një strukturë të përbërë prej 144 punonjësish dhe një buxhet prej 272.171 mijë Lekë, ndërkohë që [KLP parashikoi](#) një strukturë të përbërë nga 75 punonjës dhe një buxhet prej 215.000 mijë Lekë.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si komisioni përgjegjës [shqyrtoi](#) në datën 19 Shkurt dy projektvendimet për të dy Këshillat, specifikisht vendimin “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor” dhe vendimin “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Anëtarët e komisionit bazuar edhe në analizën dhe konsultimin e kryer me Ministrinë e Financave dhe Departamentin e Administratës Publike konsideruan se mundësitë financiare për të përmbushur kërkesat e dy Këshillave realizohen me miratimin e strukturave specifikisht të KLGJ-së me 125 punonjës dhe të KLP-së me 65 punonjës.

Dy projektvendimet e miratuara në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, janë kaluar për shqyrtim në seancë plenare dhe pritet të miratohen së shpejti.

- *Këshilli i Lartë i Prokurorisë ende me zyra të përkohshme në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme*

Pavarësisht miratimit të strukturës dhe buxhetit për vitin 2019, zgjidhja përfundimtare e përcaktimit të ambienteve dhe godinës të punës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbetet një nga problemet më aktuale dhe ende të pazgjidhura.

Këshilli i Ministrave përcaktoi në [Vendimin nr. 741 të datës 12.12.2018](#) sistemimin me mjedise pune dhe ushtrimin e veprimtarisë së organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, përfshirë KLP-në për një periudhë 25-vjeçare në ambientet e emëtuara “Komanda e Doktrinave dhe Stërvitjes”, me vendndodhje në Rrugën e Dibrës, Tiranë. Për shkak të kushteve logjistike, ky propozim u [hodh poshtë](#) nga vetë anëtarët e KLP-së.

Megjithëse e konsideruar si një zgjidhje afatmesme, në [mbledhjen e dytë](#) të Këshillit, Kryetari i këtij organi deklaroi se zyrat e institucionit do të jenë në ambientet ku ka zhvilluar veprimtarinë Autoriteti Rrugor Shqiptar. Për shkak se edhe këto ambiente janë ende në proces rikonstruksioni KLP është detyruar të zhvillojë mbledhjet në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), ish-KLD, ndërkohë që ndan disa zyra të përbashkëta në Ministrinë e Drejtësisë.

Megjithatë duket se edhe zyrat e Ministrisë së Drejtësisë mbeten të papërshtatshme për të përballuar ngarkesën e punës së KLP-së. Gjatë muajit janar 2019, kryetari i KLP-së i është drejtuar me një [shkresë zyrtare](#) Prokurores së Përgjithshme, në të cilën i ka kërkuar shfrytëzimin e disa ambienteve në godinën e Prokurorisë së Përgjithshme, për një periudhë kohore, deri në akomodimin përfundimtar në ndërtesën e vënë në dispozicion nga Këshilli i Ministrave.

Përcaktimi përfundimtar i ambienteve të punës së KLP-së, organi më i rëndësishëm në vend për menaxhimin e sistemit të prokurorisë mbetet një problem shqetësues edhe për vetë anëtarët e Këshillit, të cilët e kanë risjellë në vëmendje nevojën për zgjidhje edhe në [mbledhjen më të fundit](#).

Në kushtet kur KLP do të duhet të menaxhojë një volum pune në rritje dhe të realizojë detyrat më të rëndësishme ku ndër të tjera përfshihen, shqyrtimi i dosjeve të kandidatëve për prokurorë në PP, hapja e garës për Prokuror të Përgjithshëm apo shqyrtimi i dosjeve në kuadër të procesit të rivlerësimit, akomodimi përfundimtar në ambiente të përshtatshme pune, të cilat i përgjigjen kësaj dinamike, mbetet një ndër çështje bazike dhe kryesore për funksionimin normal të institucionit.